



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 6082 Prot.

Lezhë, më 06 . 04 . 2021

VENDIM

Nr. 72 Datë 30 . 03 . 2021

PËR

Miratimin e kërkesës së Bashkisë Lezhë së bashku me dokumentacionin tekniko-ligjor për akordimin e ndihmes financiare për dëmin e shkaktuar nga permbytja të banesës së shtetasit Bajram Ruzhdi Rustja, banor në Shengjin, Njësia Administrative Shengjin, Bashkia Lezhë.

Në mbështetje të nenit 54 të ligjit 139/2015 "Për Veteqeverisjen Vendore" Ligji Nr.45/2019 "Për Mbrojtjen Civile", VKM Nr.329, dt.16.05.2012 "Për Kriteret dhe Procedurat e dhenies së ndihmes shteterore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqesi natyrore ose fatkeqesi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore", pasi u njoh me relacionin e pergatitur nga Drejtoria e Emergjencave Civile, mbi dëmin e shkaktuar në banesën e Z.Bajram Ruzhdi Rustja, banor në Shengjin, Njësia Administrative Shengjin, Bashkia Lezhë, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë,

Vendosi:

1. Të miratojë kërkesën e Bashkisë Lezhë për mbështetje financiare të shtetasit Z.Bajram Ruzhdi Rustja për dëmtimin e banesës së tij nga permbytja.

A. Të miratojë dëmin e shkaktuar nga permbytja në vlerën 109000 lekë.

a) Demi i shkaktuar në ndertese 0 lekë.

b) Demi i shkaktuar në orendi, mobilje e pajisje 109000 lekë.

B. Mbështetur ne VKM. Nr 329 dt.16.05.2012, kap3, pika 3, gerrat b e ç, Kompensimi per demin e shkaktuar ne anen ndertimore te jete ne masen 50%, ndersa Kompensimi per demin e shkaktuar ne orendi, mobilje e pajisje, mbeshtetur ne kap 3, pika 3, germa d, te VKM-së së mesiperme te jete sa masa e demit te shkaktuar dhe konkretisht :


a) Vlera e Kompensimi të demit në anen ndertimore të jetë 0 lekë.

b) Vlera e Kompensimit të demit në orendi, mobilje e pajisje 109000 lekë.

Vlera totale 109000 lekë.

2. Të miratojë dokumentacionin tekniko-ligjor të hartuar nga Bashkia Lezhë.
3. Bashkia Lezhe t'i akordojë familjes së shtetasit Z.Bajram Ruzhdi Rustja me Nr.ID.G41219015W ndihmen emergjente në vleren prej 109000 (njqind e nente mije) lekë nga buxheti i Bashkisë Lezhë, fondi i Emergjencave Civile i destinuar dhe i miratuar nga Keshilli i Bashkise per vitin 2021, bazuar ne VKM nr.329 dt.16.05.2012.
4. Ndhma financiare që do t'i akordohet do të përdoret për tli ardhur në ndihme familjes së shtetasit Z.Bajram Ruzhdi Rustja, banesa e të cilit është dëmtuar nga permbytja.
5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
6. Ky vendim hyn fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**SEKRETARI
FLORIDA ÇUNAJ**



**KRYETARI
ERNEST RAKAJ**

